




FOTO NGA: KPMG

# UDHËZIME MBI PLANIFIKIMIN STRATEGJIK TË AUDITIMEVE TË PERFORMANCËS

Aktiviteti i USAID-it për Komunitet Transparente, Efektive  
dhe Llogaridhënëse në Kosovë

# Aktiviteti i USAID-it për Komunitet Transparente, Efektive dhe Llogaridhënese në Kosovë

## UDHËZIME MBI PLANIFIKIMIN STRATEGJIK TË AUDITIMEVE TË PERFORMANCËS

|                                  |                                                                                                   |
|----------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Titulli i projektit:</b>      | Aktiviteti i USAID për Komunitet Transparente, Efektive dhe Llogaridhënese në Kosovë (USAID TEAM) |
| <b>Zyra sponsoruese e USAID:</b> | USAID/Kosovo                                                                                      |
| <b>Numri i kontratës:</b>        | AID-167-C-17-00001                                                                                |
| <b>COR:</b>                      | Jeton Cana                                                                                        |
| <b>Kontraktues:</b>              | DAI Global, LLC                                                                                   |
| <b>Data e dorëzimit:</b>         | Gusht, 2021                                                                                       |
| <b>Përgatitur nga:</b>           | KPMG Albania Sh.P.K Dega në Kosovë                                                                |

## PËRMBAJTJA

|                                                                                                                               |    |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Shkurtesat dhe akronimet.....                                                                                                 | iv |
| 1. sfondi.....                                                                                                                | 1  |
| 2. HYRJE.....                                                                                                                 | 2  |
| 2.1 Qëllimi.....                                                                                                              | 3  |
| 2.2 PARIMET .....                                                                                                             | 3  |
| 3. PROCESI I PLANIFIKIMIT STRATEGJIK TË AUDITIMEVE TË PERFORMANCËS.....                                                       | 4  |
| 3.1 Përcaktimi i mjedisit të jashtëm.....                                                                                     | 5  |
| 3.2 Përcaktimi i rreziqeve dhe identifikimi i sektorëve/njësive që do të përfshihen në planin strategjik .....                | 9  |
| 3.3 Përgatitja dhe miratimi i draft planit strategjik të fap, duke përfshirë një listë të fushave prioritare për auditim..... | 13 |
| 4. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË .....                                                                                              | 14 |
| 5. MONITORIMI I PLANIT STRATEGJIK .....                                                                                       | 15 |
| 6. RISHIKIMI DHE PËRDITËSIMI I PLANIT STRATEGJIK .....                                                                        | 16 |
| SHTOJCA 1: Shembull studimi i përgjithshëm (word).....                                                                        | 17 |
| SHTOJCA 2: Lista e subjekteve të sektorit publik - të audituarit (excel) .....                                                | 18 |
| SHTOJCA 3: Modeli i vlerësimit të rrezikut (excel).....                                                                       | 19 |
| SHTOJCA 4. Modeli i planit strategjik të auditimeve të performancës .....                                                     | 20 |
| SHTOJCA 5: Shembull masat e performancës.....                                                                                 | 21 |
| SHTOJCA 6: shablloni i rishikimit dhe miratimit të dokumentit .....                                                           | 22 |
| SHTOJCA 7: Lista e burimeve.....                                                                                              | 23 |

## SHKURTESAT DHE AKRONIMET

|           |                                                                 |
|-----------|-----------------------------------------------------------------|
| AP        | Auditori i Përgjithshëm                                         |
| KMFB      | Komisioni për Mbikqyrjen e Financave Publike                    |
| INTOSAI   | Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit  |
| ISA       | Standardet Ndërkombëtare të Auditimit                           |
| ISSAI -të | Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit |
| IT        | Teknologjia e informacionit                                     |
| ZKA       | Zyra Kombëtare e Auditimit                                      |
| FAP       | Funksioni i Auditimit të Performancës                           |
| KBFP      | Kontroli i Brendshëm Financiar Publik                           |
| SPP       | Subjekti i Sektorit Publik                                      |
| ISA       | Institucioni Suprem i Auditimit                                 |
| TEAM      | Komunat Transparence, Efektive dhe Llogaridhënëse               |
| USAID     | Agjencia e SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar                    |

## I. SFONDI

TEAM është një projekt pesë-vjeçar i financuar nga USAID në Kosovë që ka filluar më 11 Janar 2017 dhe është planifikuar të përfundojë në Janar të vitit 2022. Ky projekt është dizajnuar për ta përmirësuar drejtësinë, transparencën dhe mbikëqyrjen e prokurimit duke ofruar asistencë gjithëpërfshirëse në 38 komunat e Kosovës me theks të veçantë në pesë komuna në fokus, përmes mentorimit, trajnimit dhe udhëzimeve për ta përmirësuar llogaridhënien për fondet dhe shpenzimet publike.

Në nivelin qendror, TEAM do ta përdorë përkrahjen për përpjekjet komunale kundër korrupsionit, duke punuar afër me një larmi akterësh të nivelit kombëtar - përfshirë Ministrinë e Financave, Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrinë e Administratës Publike, Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, Zyrën Kombëtare të Auditimit, Organin Shqyrtues të Prokurimit, Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës - si dhe me partnerë nga të 38 komunat.

Projekti TEAM përbëhet nga komponentët e mëposhtëm:

- Komponenti 1: Zhvillimi, rafinimi dhe zbatimi i modeleve për komunat transparente dhe llogaridhënëse.
- Komponenti 2: Angazhimi i nivelit qendror për trajtimin e korrupsionit komunal në procesin e prokurimit.
- Komponenti 3: Mundësimi që shoqëria civile ta gjurmojë dhe ekspozojë korrupsionin.

Ky raport jepet nën Komponentin 2, Aktiviteti 2.1 "Ndërtimi i kapaciteteve të ZKA në fushat e zbulimit të mashtrimit në nivel të qeverisjes vendore", Nën-aktiviteti 2.1.2. "Mbështetja ZKA -së në prezantimin e planifikimit strategjik në auditimin e performancës". Ky aktivitet ka për qëllim ta përkrahë Funksin e Auditimit të Performancës për të futur në përdorim një procedurë të brendshme të formalizuar për planifikim strategjik në auditimin e performancës, e cili do t'i përcaktojë fazat e procesit, njësitë dhe stafin përgjegjës, rolet e tyre specifike, dokumentet e punës dhe mjetet për dokumentimin e procesit, burimet e informacionit si dhe koordinimin me departamentet e tjera të auditimit. Fushat prioritare dhe objektivat strategjike të veprimtarisë së auditimit të performancës duhet të marrin parasysh: mandatin ligjor, misionin, vizionin dhe vlerat, qëllimet dhe objektivat strategjike për zhvillimin e ZKA-së siç përcaktohen në Planin Strategjik për periudhën përkatëse (d.m.th Plani Strategjik i ZKA-së për 2018-2021), analizën e zhvillimit social-ekonomik të shtetit, analizën e rrezikut të sektorëve dhe analizën e ndikimit të aktivitetit të auditimit të ZKA-së si dhe nevojat për përmirësim në sektorin publik.

## 2. HYRJJE

Këto Udhëzime paraqesin procesin e planifikimit strategjik të auditimit të performancës që mund të përdoret si mjet i bazuar në rrezik nga Funkcioni i Auditimit të Performancës së ZKA-së (FAP) në mënyrë që:

- Të fokusojnë burimet në fushat me rëndësi që duhet të sillen në vëmendjen e Kuvendit të Kosovës
- Ta promovojnë qëndrueshmërinë në planifikimin e temave të auditimit në të gjitha ekipet e auditimit të performancës së ZKA, dhe
- Të organizohet procesi i përzgjedhjes së auditimeve sipas rreziqeve kryesore në njësitë ose në subjektet funksionale, si dhe në prioritetet dhe fushat e fokusit të ZKA-së.

Auditorët duhet t'i zgjedhin temat e auditimit përmes procesit të planifikimit strategjik të ZKA-së duke i analizuar temat e mundshme dhe duke hulumtuar për t'i identifikuar rreziqet dhe problemet. Duke ndjekur parimet e auditimit të performancës të përcaktuara në ISSAI 300, teknikat formale për përgatitjen e procesit të planifikimit strategjik, të tilla si analiza e rrezikut ose vlerësimet e problemeve duhet të plotësohen me gjykim profesional për t'i shmangur vlerësimet e njëanshme.

Cikli i planifikimit të auditimit ndjek fazat e paraqitura më poshtë:

- **Misioni, vizioni dhe objektivat strategjikë të ZKA-së** sigurojnë një bazë për planifikimin korporativ dhe një kuadër të përgjithshëm për aktivitetet e auditimit të ZKA-së. Këto deklarata përfshihen në planin strategjik të ZKA-së për periudhën përkatëse trevjeçare. Plani strategjik përcakton strategjinë e përgjithshme të biznesit për ZKA lidhur me përmbushjen e misionit kushtetues dhe ligjor; zhvillimin dhe forcimin e kapaciteteve institucionale; zhvillimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve të mira me akterët e jashtëm, promovimin e auditimit, rritjen e ndikimit dhe integrimin në organizatat ndërkombëtare dhe rajonale të Institucioneve Supreme të Auditimit.
- **Plani strategjik i auditimit** është i nevojshëm për përcaktimin e punës që kërkohet për t'i përmbushur qëllimet dhe detyrat e ZKA-së, si do të realizohen këto dhe me çfarë burimesh. Ky proces planifikimi duhet ta përcaktojë punën për vitet në vazhdim, duke iu nënshtruar rishikimit të ndryshimit të rrethanave. Menaxhmenti i Lartë i FAP duhet ta propozojë planin strategjik, në përputhje me misionin dhe deklaratat e vizionit të ZKA dhe objektivat e korporatës, për miratimin e Auditorit të Përgjithshëm.
- **Plani vjetor i auditimit** mbulon planifikimin e buxhetit dhe burimeve njerëzore, dhe detaje mbi temat e auditimit që do të mbulohen brenda sezonit të auditimit. Sipas Ligjit për AP dhe ZKA, ky plan i paraqitet Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike (KMFP) që nga 31 Tetori, çdo vit.
- **Plani individual i auditimit** është i nevojshëm për të dhënë detaje mbi një auditim specifik nga plani vjetor i auditimit. Ai e shtrin vlerësimin e bërë në procesin e planifikimit vjetor dhe qëllimi i tij është të japë arsyetim të mjaftueshëm për të vazhduar me studim kryesor ose për të përfunduar punë të mëtejshme. Në këtë fazë, ekipet e auditimit e përgatisin studimin paraprak, modelin e auditimit dhe planin e punës për një auditim specifik.

Fazat e veçanta të ciklit të planifikimit të auditimit janë paraqitur në figurën më poshtë:




Figura 1, Cikli i planifikimit të auditimit

## 2.1 QËLLIMI

Qëllimi i këtyre Udhëzimeve është të shërbejnë si bazë për një proces planifikimi strategjik të strukturuar mirë të Funkcionit të Auditimit të Performancës. Rezultati kryesor i procesit të planifikimit strategjik është një dokument i cili është përgatitur në përputhje me objektivat e përgjithshme strategjike të ZKA dhe i jep prioritetet për auditimin e performancës për periudhën e mbuluar (një periudhë trevjeçare).

Udhëzimet duhet të përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në mënyrë që të pasqyrojnë çdo ndryshim organizativ, aspekte të reja në metodologjinë e auditimit të performancës, ndryshime në kuadrin e përgjithshëm strategjik të ZKA-së ose ndryshime në mjedisin e jashtëm.

## 2.2 PARIMET

Këto Udhëzime përfshijnë parimet kryesore të mëposhtme:

- **Mandati dhe pavarësia:** Mandati dhe qëllimi kryesor i ZKA-së është të përmbushë funksionin e pavarur të auditimit të jashtëm të fondeve publike, ekzekutimit të buxhetit, përdorimit dhe qeverisjes së burimeve publike. Shtrirja e mandatit të auditimit përcaktohet në Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm (AP) dhe ZKA. AP si Drejtues i ZKA-së, është përgjegjës para Kuvendit për realizimin e detyrave dhe kompetencave të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj, në akte nënligjore dhe standarde të njohura ndërkombëtarisht të auditimit të sektorit publik. AP është funksionalisht, financiarisht dhe operacionalisht i pavarur dhe nuk i nënshtrohet drejtimit ose ndikimit nga asnjë person ose institucion.
- **Qasja e bazuar në rrezik<sup>1</sup>:** Në planifikimin strategjik të auditimit të performancës, auditorët zbatojnë qasjen e bazuar në rrezik e cila përfshin fokusimin e kapacitetit të auditimit dhe përpjekjeve në fushat kryesore të rrezikut në universin e auditimit. Kjo metodë optimizon shpërndarjen e burimeve dhe adreson çështjet kryesore. Matrica e rrezikut me rreziqet e identifikuara dhe vlerësimet e rrezikut përdoret për të paraqitur një pasqyrë të rreziqeve në fushat e auditimit. Sipas ISSAI 300, Parimet e Auditimit të Performancës: Auditorët duhet të zgjedhin temat e auditimit përmes procesit të

1 Përdorimi i Vlerësimit të Rrezikut në Planifikimin e Auditimit të Performancës Shumëvjeçare, OECD, 2018

3| Udhëzime mbi planifikimin strategjik të auditimeve të performancës

planifikimit strategjik të ISA-s, duke analizuar temat e mundshme dhe duke bërë kërkime për të identifikuar rreziqet dhe problemet. Analiza e rrezikut duhet të plotësohet me gjykimin profesional të auditorëve për të siguruar që procesi i përgjithshëm është i balancuar.

- **Konsistenca:** Strategjia e propozuar e auditimit të performancës duhet të jetë në përputhje me mandatin e auditimit të ZKA-së dhe duhet të sigurojë qëndrueshmëri të përgjithshme brenda objektivave, misionit, vizionit dhe vlerave të ZKA-së.

### 3. PROCESI I PLANIFIKIMIT STRATEGJIK TË AUDITIMEVE TË PERFORMANCËS

Plani strategjik i auditimit të FAP përcakton një pikë fillestare të rëndësishme në vendosjen e asaj që do të auditohet; është baza për përzgjedhjen e temave të auditimit në planifikimin vjetor dhe studimet paraprake.

Procesi i planifikimit strategjik të auditimeve të performancës arrihet duke i ndjekur hapat e mëposhtëm:

- **Hapi 1** - Përcaktimi i mjedisit të jashtëm brenda të cilit operojnë njësitë e sektorit publik
- **Hapi 2** - Përcaktimi i rreziqeve dhe identifikimi i sektorëve/njësive që do të përfshihen në planin strategjik
- **Hapi 3** - Përgatitja dhe miratimi i draft planit strategjik të FAP, duke përfshirë një listë të fushave prioritare për auditim

Procesi i planifikimit të auditimit strategjik përshkruhet në figurën më poshtë:




Figura 2, Procesi i planifikimit të auditimit strategjik të performancës

### 3.1 PËRCAKTIMI I MJEDISIT TË JASHTËM

Përcaktimi i mjedisit të jashtëm është një hap themelor në përgatitjen e një plani strategjik të auditimit të performancës. Mjedisi i sektorit publik i integron të gjitha proceset, programet, funksionet dhe entitetet e auditueshme. Ai përfshin juridiksionet në të cilat ZKA-ja ka mandat auditimi për ta realizuar qëllimin e vet dhe për t'i arritur objektivat e veta, si dhe subjektet e sektorit publik, temat dhe llojet e auditimeve që ajo e ka fuqinë t'i realizojë.

Para se të propozohen fusha të mundshme të auditimit të performancës, është e dobishme që auditorët, të përfshirë në procesin e planifikimit strategjik, t'i kuptojnë mirë të mëposhtmet:

- Kushtet e përgjithshme ekonomike dhe të veprimtarisë së caktuar
- Zhvillimet shoqërore dhe teknologjike
- Prioritetet, qëllimet, objektivat dhe programet e qeverisë
- Mjedisin rregullator, përkatësisht kornizën ligjore dhe atë politike.

Ekipet e auditimit realizojnë një pjesë të këtij procesi në baza të vazhdueshme përmes njohurive të tyre mbi aktivitetet përkatëse, të cilat përfshijnë takime periodike me zyrtarë të subjekteve të sektorit publik; rishikim të dokumenteve kryesore të subjekteve; dhe monitorimin e aktiviteteve dhe raporteve të mediave të Komiteteve të Kuvendit.



Figura 3, Burimet e mbledhjes të informacionit

Një proces më intensiv për të marrë informacion të përditësuar, për qëllimet e procesit të planifikimit të auditimit strategjik, zhvillohet për secilën zonë funksionale, fushë ose sektor që mbulon subjektet përkatëse të sektorit publik.

Një qasje e zakonshme për të përfaqësuar fushat e auditimit është sipas strukturës organizative, duke paraqitur çdo subjekt të sektorit publik me nënndarjet dhe fushat e veta të programit. Kjo qasje funksionon

mirë për mbledhjen e të dhënave, pasi subjektet shpesh japin informacion në përputhje me strukturat, programet dhe nënndarjet e tyre të brendshme. Fushat e auditimit mund të përfshijnë edhe shumë aktivitete ndër-funksionale që duhet të merren parasysh, siç janë burimet njerëzore, sistemet e informacionit, menaxhimi dhe prokurimi. Programet, objektivat e politikave dhe çështjet që janë përgjegjësi e njësive të shumta duhet të përcaktohen gjithashtu.

### **Mjetet e mbledhjes së informacionit**

Krijimi i një pamje gjithëpërfshirëse të fushave, sektorëve ose fushave funksionale kërkon qasje në informacion të saktë. Informacioni mbi përcaktimin e mjedisit të jashtëm brenda të cilit funksionojnë subjektet e sektorit publik mund të merret duke përdorur mjete të ndryshme për identifikimin e fushave dhe temave.

Mjetet e mëposhtme përfshihen në praktikat e ZKA-së dhe mund të përdoren për të marrë informacion për planifikimin strategjik:

#### **3.1.1 VËZHGIMI I FUSHËS**

Vëzhgimi i fushës nënkupton monitorimin e çështjeve kryesore në sektorin publik për të ndjekur zhvillimet. Qëllimi i tij është të identifikohen fushat e mundshme të auditimit për vlerësim të mëtejshëm. Ai realizohet duke lexuar publikimet përkatëse dhe raportet e mëparshme të auditimit në lidhje me auditimet e performancës dhe pajtueshmërisë, duke analizuar dhe diskutuar përvojën e auditorëve të rregullsisë, duke dëgjuar ose lexuar transkriptet e debateve parlamentare, duke marrë pjesë në konferenca dhe seminare, diskutime me kolegët, palët e interesit dhe specialistët, duke dëgjuar transmetimet në radio dhe televizion, dhe duke lexuar gazetatat dhe revistat.

Vëzhgimi i fushës duhet të jetë një proces i vazhdueshëm për të siguruar që ZKA është në dijeni për informacionin e përditësuar në lidhje me atë që ndodh në shoqëri dhe fushat që mund të kërkojnë ekzaminim të mëtejshëm.

Lista e mëposhtme e informacionit që mund të merret parasysh përfshin:

- Komisionin për Mbikëqyrjen e Rezolutave të Financave Publike, raportet ose të tjera
- Fjalimet e Presidentit/es që shënojnë hapjen e vitit parlamentar, ku zakonisht marrin pjesë figura të rëndësishme politike dhe qeveritare
- Buxhetet dhe udhëzimet kombëtare
- Dokumente të tjera të lidhura me politikat
- Zhvillimet globale siç janë temat e identifikuara nga INTOSAI
- Media duke përfshirë lajme, artikuj, shqetësime të ngritura nga publiku.

#### **3.1.2. EKZAMINIMI I MJEDISIT**

Për qëllimet e ekzaminimit të mjedisit, mund të kryhet analiza PEST duke marrë parasysh faktorët e mëposhtëm që mund të ndikojnë në aktivitetet/subjektet e sektorit publik:

- **Politikë:** zgjedhjet, politika dhe prioritetet e qeverisë, stabiliteti politik, korrupsioni, politikat tatimore.

- **Ekonomikë:** rritja ekonomike, kurset e këmbimit, normat e interesit, normat e papunësisë, ekonomitë kryesore të paqëndrueshme.
- **Socialë:** shkalla e rritjes së popullsisë, shpërndarja e moshës, barrierat kulturore, theksi i sigurisë, protesta masive, rreziqet e shëndetit dhe sigurisë të COVID-19.
- **Teknologjikë:** automatizimi, ndryshimet teknologjike, ndërgjegjësimi teknologjik, tregtia elektronike.

### **3.1.3 SONDAZHE TË PËRGJITHSHME, SONDAZHE NGA ZKA DHE KËRKIME NGA INSTITUCIONE TË TJERA**

Si pjesë e kontakteve të tyre normale të auditimit, auditorët do të kenë krijuar njohuri të konsiderueshme të mbledhura për organizatat në të cilat ata punojnë. Përveç kësaj, kërkohen informacione të mëtejshme mbi të cilat do të bazohet një program auditimi. Sondazhet e përgjithshme mund të mbulojnë një subjekt të tërë, një grup aktivitete të lidhura, projekte ose programe të veçanta të mëdha të shpenzimeve.

Sondazhi i përgjithshëm ka për qëllim që të kuptohen objektivat e organizatës, aktivitetet e saj kryesore dhe niveli dhe natyra e burimeve të përdorura në realizimin e funksioneve të saj. Informacioni mblidhet dhe vlerësohet mbi sfondin, objektivat, aktivitetet, planet, burimet, procedurat dhe kontrollat në njësitë ose zonat në fjalë.

Pjesa më e madhe e informacionit për punën e përgjithshme të anketimit mund të merret përmes punës normale të përditshme dhe kontaktit me organizatat e sektorit publik. Kjo mund të veprojë si një listë kontrolli e informacionit të kërkuar të sfondit që mbulon me sa vijon:

- ✓ Mjedisi dhe informacioni mbi subjektin
- ✓ Autoriteti legjislativ relevant
- ✓ Objektivat e subjektit të audituar
- ✓ Aranzhimet organizative
- ✓ Marrëdhëniet e llogaridhënies
- ✓ Aktivitetet e realizuara
- ✓ Natyra dhe niveli i burimeve të përdorura
- ✓ Procedurat dhe sistemet e kontrollit në vend
- ✓ Informacion ose dëshmi të tjera relevante.

Një model shabllon për studim të përgjithshëm është paraqitur në **Shtojcën I**.

Auditorët mund të mbështeten dhe të përdorin informacionin e mbledhur përmes llojeve të ndryshme të sondazheve të realizuara nga ZKA.

Dokumentet kërkimore, raportet dhe materialet e tjera të prodhuara nga institucione të tjera kombëtare dhe/ose ndërkombëtare gjatë punës së tyre (p.sh. agjencitë shtetërore të Kosovës, EUROSAT, INTOSAI, Komisioni Evropian, etj.) mund të përdoren nga auditorët për të marrë informacionin përkatës lidhur me qëllimet e planifikimit strategjik.

### **3.1.4 DISKUTIMET DHE VLERËSIMET E BRENDSHME BREND ZKA-SË**

Diskutimet e brendshme për të debatuar dhe vlerësuar rreziqet që lidhen me fushat e mundshme të auditimit dhe subjektet e sektorit publik duhet të zhvillohen brenda ZKA-së.

Ekipi përgjegjës i planifikimit strategjik mund të inicojë dhe të marrë pjesë në sesione të nxjerrjes së ideve („Brainstroming“), takime individuale ose ndër-funksionale të organizuara me Auditorët Financiarë dhe të Pajtueshmërisë, Departamentin Kundër Mashtrimit dhe të Çështjeve Ligjore dhe Departamentin e Metodologjisë dhe Sigurimit të Cilësisë për të diskutuar fushat e mundshme të rrezikut dhe rreziqet specifike bazuar në analizën e të dhënave, raportet e mëparshme të auditimit dhe ndjekjen e rekomandimeve të prodhuara gjatë punës së departamenteve të auditimit.

Departamentet e auditimit duhet të informohen në përputhje me rrethanat nga Menaxhmenti i Lartë për fillimin e procesit të planifikimit strategjik të FAP, në mënyrë që të jenë në gjendje ta ndihmojnë procesin me informacionin përkatës në kohën e duhur.

### **3.1.5. MARRJA PARASYSH E PIKËPAMJEVE TË QYTETARËVE**

Perspektiva e shoqërisë civile që lidhet me performancën e subjektit të audituar duhet të merret parasysh aty ku është e përshtatshme. Është e rëndësishme të merren parasysh interesat e qytetarëve në auditimet e performancës. Qytetarët janë burim i ideve për auditimin e performancës, një burim i kërkesës për auditimin e performancës si dhe përdorues të raporteve të auditimit të performancës.

Menaxhmenti i Lartë me propozim të ekipit të planifikimit strategjik mund të inicojë tryeza të rrumbullakëta duke publikuar një ftesë në faqen zyrtare të ZKA-së me detaje për vendin, datën, kohën dhe objektivat e tryezës së rrumbullakët. Ekipi i planifikimit strategjik përgatit agjendën dhe procesverbalin e takimit nga diskutimet publike për t'u përdorur si një kontribut në procesin e planifikimit.

### **Dosjet e përhershme**

Për qëllime të procesit të planifikimit strategjik, Menaxhmenti i Lartë i FAP mund të vendosë për krijimin e dosjeve të përhershme të auditimit (dosje fizike ose/dhe dosje elektronike) në mënyrë që ta mbajë informacionin dhe dokumentet në dispozicion të mbledhura gjatë procesit të planifikimit. Këto dosje kanë rëndësi themelore për planifikimin e punës së auditimit dhe ekzekutimin e tij të mëvonshëm. Ato përmbajnë informacionin që do të përdoret vit pas viti në ciklin e planifikimit dhe në auditimet e njëpasnjëshme në një fushë të caktuar.

Dosjet e përhershme mund të organizohen sipas subjektit ose zonës/sektorit funksional (p.sh. Shëndetësia, Arsimi, Mjedisi, Infrastruktura, etj.) dhe duhet të përditësohen rregullisht.

Dosja e auditimit të përhershëm mund të ketë përmbajtjen e mëposhtme:

- Informacion lidhur me strukturën ligjore dhe organizative të subjektit, funksionet dhe aktivitetet kryesore, (p.sh. grafikët organizativë me detajet e departamenteve, rregullat e procedurës, organigrami)
- Ekstrakte nga dokumente të rëndësishme ligjore
- Plane vjetore, dokumentet strategjike dhe raporte vjetore të performancës

- Të dhëna të vlerësimit të kontrolleve të brendshme: pyetësorë dhe lista kontrolli
- Raporte të mëparshme të auditimit, procesverbale dhe dokumente të takimeve
- Informacione të tjera relevante të marra në procesin e procesit të planifikimit strategjik.

### **Lista e subjekteve të sektorit publik (të audituarve)**

FAP duhet ta krijojë dhe mbajë një listë të përditësuar të subjekteve të sektorit publik, duke përfshirë një listë të menaxhmentit të lartë dhe detajet e kontakteve, të cilat përfshihen në fushën e mandatit të auditimit të ZKA-së (përcaktuar në nenin 18 të Ligjit Nr. 05/L-055 për AP dhe ZKA).

Një listë shembull i subjekteve të sektorit publik është paraqitur në **Shtojcën 2**.

**Rezultati i Hapit 1:** Një listë e plotë e fushave të mundshme të auditimit dhe subjekteve të sektorit publik dhe një listë e detajeve të kontaktit të menaxhmentit të lartë

## **3.2 PËRCAKTIMI I RREZIQEVE DHE IDENTIFIKIMI I SEKTORËVE/NJËSIVE QË DO TË PËRFSHIHEN NË PLANIN STRATEGJIK**

Pasi të përcaktohen fushat e auditimit dhe të ketë një pasqyrë të qartë të të gjitha fushave të mundshme të auditimit, ekipi përgjegjës i planifikimit strategjik duhet të identifikojë se ku do t'i kushtojë kohë dhe burime. Këtu mund të përfshihet vlerësimi i rrezikut për t'u ndihmuar auditorëve të performancës që t'i përdorin sa më mirë burimet e tyre për të pasur ndikim më të madh dhe për të arritur në mënyrë më efektive qëllimin dhe objektivat e tyre.

Vlerësimi i rrezikut si një proces i cili përfshin tre fazat e mëposhtme: (i) identifikimi i rrezikut, (ii) analiza e rrezikut dhe (iii) vlerësimi i rrezikut (prioritizimi).

### **3.2.1. IDENTIFIKIMI I RREZIKUT**

Në këtë fazë të procesit të vlerësimit të rrezikut, auditorët duhet të identifikojnë lloje të ndryshme të rreziqeve ose problemeve bazuar në informacionin e marrë në Hapin I.

Faktorët e rrezikut dhe rreziqet mund të identifikohen për të gjithë sektorin publik; për fushën funksionale ose subjektet individuale të sektorit publik; dhe rreziqe të reja në shfaqje e sipër.

#### *Rreziqet e sektorit publik*

- Rreziqet strategjike dhe operacionale me të cilat përballen fushat/subjektet e sektorit publik, përfshirë ndryshimin e prioriteteve të qeverisë
- Faktorët socialë, kulturorë, politikë, juridikë, rregullativë, financiarë, teknologjikë, ekonomikë dhe mjedisorë (përfshirë ndërkombëtarë, kombëtarë, rajonalë ose lokalë).
- Rreziku që përfshin faktorë të jashtëm si ndryshimi i klimës, pandemia në mbarë botën, globalizimi.

#### *Rreziqet e subjekteve individuale të sektorit publik*

Këto rreziqe zakonisht identifikohen nga menaxhmenti i lartë i subjektit dhe lidhen me objektivat e subjekteve dhe prioritetet e qeverisë. Nëse auditorët e ZKA-së kanë qasje në vlerësimet e brendshme të rrezikut (politika e menaxhimit të rrezikut dhe veprimet e identifikimit dhe zbutjes së rrezikut të SSP-ve, sipas nenit 12 të Ligjit për KBFP) për secilin subjekt dhe ato janë të zhvilluara dhe të besueshme, ato mund të merren në konsideratë gjatë procesit. Nëse rreziqet brenda subjekteve nuk janë identifikuar dhe dokumentuar qartë, auditorët mund ta bëjnë identifikimin e tyre të rrezikut bazuar në dokumentacionin në dispozicion, auditimet e kaluara dhe në bazë të diskutimeve të brendshme brenda ZKA-së dhe konsultimit me akterët e jashtëm, (duke përdorur mjetet e mbledhjes së informacionit të përshkruara në Udhëzime).

#### *Rreziqet e reja*

Auditorët gjithashtu duhet t'i marrin në konsideratë rreziqet e reja që lidhen me ndryshimin e rrethanave dhe mjedisit të jashtëm brenda fushave dhe subjekteve të auditimit të përcaktuara si pjesë e mandatit të auditimit, në mënyrë që të lënë hapësirë për fleksibilitet në planin strategjik të auditimit për shfaqjen e rreziqeve të reja.

Është e rëndësishme që auditorët ta kuptojnë fushën/sektorin funksional, subjektet dhe proceset përkatëse që përfundimisht mund të jenë subjekt auditimi. Kërkohet njohuri e mjaftueshme për fushën e auditimit për të gjykuar nëse ekziston mundësia për përmirësime në performancë, duke rezultuar kështu që fusha/sektori i auditimit të përfshihet në planin strategjik. Prandaj, mbledhet dhe vlerësohet informacioni mbi sfondin, objektivat, aktivitetet, planet, burimet, procedurat dhe kontrollet në njësitë ose fushat e propozuara në fjalë.

Qëllimi është që:

- ✓ Të Identifikohen faktorët e rëndësishëm që mund të ndikojnë në fushat/subjektet funksionale dhe proceset në fjalë
- ✓ Të identifikohen dhe rishikohen ato fusha që absorbojnë një nivel të konsiderueshëm burimesh
- ✓ Të identifikohen rreziqet e mundshme për arritjen e një Vlere të mirë për Para
- ✓ Të theksohen fushat për vëmendjen e vazhdueshme të auditimit
- ✓ Të propozohen fushat prioritare të auditimit për përfshirje në planin strategjik.

Më poshtë janë dhënë shembuj të faktorëve dhe ngjarjeve që mund të tregojnë rreziqe ose probleme në fusha/sektore dhe/ose subjektet funksionale të sektorit publik:

- Sektorët e menaxhimit kompleks, të cilët përfshijnë organizata të ndryshme të sektorit publik ose organizata joqeveritare
- Mungesa e informacionit të besueshëm ose të përditësuar mbi performancën e organizatës së audituar në lidhje me arritjen e objektivave, vlerës së produkteve dhe shërbimeve, etj.
- Problemet strukturore dhe të kontrollit si dhe problemet që lidhen me planifikimin e aktiviteteve
- Mungesa e qartësisë në lidhje me qëllimet, përgjegjësitë dhe procesin e vendimmarrjes
- Probleme operationale me sistemet kompjuterike
- Shpenzimet e tepërta të buxhetit për shkak të kontroleve të dobëta buxhetore
- Privatizimet
- Programet e reja
- Ndryshime të mëdha në programet ekzistuese

- Burimet e reja të financimit
- Legjislacioni dhe rregulloret ose direktivat e reja
- Vendimet politike të tilla si rilokimi e operacioneve
- Programet pa burime dhe fonde të mjaftueshme të alokuara
- Rritja e pritshmërive të publikut
- Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve në industri të caktuara siç është mbrojtja
- Transferimi i aktiviteteve të qeverisë
- Operacionet që janë subjekt i hetimeve të veçanta
- Ndryshimet në lidhshmëri politike
- Indikacionet e shpërdorimit ose abuzimit
- Pritshmëritë më të larta se normale për ta përmbushur buxhetin, dhe
- Partneritet publiko-privat.

Shembuj të kategorive të rrezikut dhe rreziqeve individuale jepen në **Shtojcën 3, fleta Excel 3**.

**Rezultati i identifikimit të rrezikut:** *Një listë e rreziqeve të identifikuara sipas sektorit ose subjektit funksional.*

### 3.2.2. ANALIZA E RREZIKUT

Në këtë fazë tjetër të procesit, faktorët e identifikuar të rrezikut për sektor ose subjekt vlerësohen, bazuar në dy tregues:

- **Probabiliteti** - gjasat që rreziku i identifikuar të ndodhë (probabiliteti nënkupton shpeshtësinë e ndodhjes së një ngjarjeje), dhe
- **Ndikimi**- ndikimi i rrezikut, pra efekti ose pasojat që dalin nga ndodhja e rrezikut (ndikimi nënkupton pasojat të shkaktuara nga ndodhja e një ngjarjeje). Vlerësimi i ndikimit mund të bazohet në kritere të përshtatura siç janë: ndikimi në objektiva, pajtueshmëri, financat, etj dhe pasojat e tyre të parashikueshme.

Analiza e rrezikut kryhet bazuar në një shkallë të përcaktuar për matjen e probabilitetit dhe ndikimit, p.sh. e ulët, e mesme dhe e lartë. Matja e nivelit të përgjithshëm të rrezikut është një kombinim i probabilitetit dhe ndikimit.

Procesi i vlerësimit bazohet në gjykimin profesional të auditorëve si një kombinim i ekspertizës dhe përvojës, dhe në nivelin e informacionit në dispozicion (gjykim i informuar dhe subjektiv).

**Probabiliteti** mund të vlerësohet duke përdorur shkallën e mëposhtme:

| Probabiliteti i Vlerësuar |                  |
|---------------------------|------------------|
| Rezultati                 | Probabiliteti    |
| 3                         | Me shumë mundësi |
| 2                         | Me gjasë         |
| 1                         | I rrallë         |

Figura 4, Shkalla e vlerësimit të probabilitetit

**Ndikimi** mund të vlerësohet duke përdorur kategoritë e mëposhtme: "I lartë" (rezultati 3); "I mesëm" (rezultati 2); "I ulët" (rezultati 1).

Vlerësimi bazohet në marrjen parasysh të tre kritereve specifike të cilat janë përcaktuar, si më poshtë:

- Kriteri 1 - "Ndikimi në objektiva"
- Kriteri 2 - "Pajtueshmëria"
- Kriteri 3 - "Financiar"

| Ndikimi i vlerësuar |         |                                                            |                                                                                    |                                       |
|---------------------|---------|------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------|
| Rezultati           | Ndikimi | Kriteri 1<br>Ndikimi në objektivat                         | Kriteri 2<br>Pajtueshmëria                                                         | Kriteri 3<br>Financiar                |
| 3                   | I Lartë | Objektivat strategjike të pa arritura                      | Mosrespektimi i ligjeve dhe / ose rregulloreve që rezultojnë në ndjekje penale     | Ndikim i rëndë financiar              |
| 2                   | I mesëm | Ndikim shumë i madh në arritjen e objektivave strategjike  | Mosrespektimi i ligjeve dhe /ose rregulloreve me një ndëshkim administrativ pasues | Ndikim i lartë financiar              |
| 1                   | I ulët  | Pak ose aspak ndikim në arritjen e objektivave strategjike | Mosrespektimi i ligjit dhe/ ose rregulloreve me efekt të kufizuar                  | I ulët deri në asnjë ndikim financiar |

Figura 5, Shkalla e vlerësimit të ndikimit

Çdo kriter ka tre hipoteza të ndryshme që duhet të merren parasysh në procesin e vlerësimit të ndikimit. Vlerësimi i ndikimit bëhet duke marrë parasysh kriteret përkatëse për rrezikun përkatës dhe duke formuluar një rezultat të përgjithshëm i cili ndikohet nga rezultati më i lartë i caktuar. Vlerësimi i përgjithshëm do të varet nga gjykimi profesional i auditorëve dhe informacioni në dispozicion.

**Niveli i rrezikut** është rezultat i kombinimeve të ndryshme të probabilitetit dhe ndikimit. Përcaktohet duke përdorur Matricën e Rrezikut:

| Probabiliteti x Ndikimi |          |           |           |
|-------------------------|----------|-----------|-----------|
| Probabiliteti           | Ndikimi  |           |           |
|                         | 1   ulët | 2   mesëm | 3   lartë |
| 3 Me shumë mundësi      | 3        | 6         | 9         |
| 2 Me gjasë              | 2        | 4         | 6         |
| 1 I rrallë              | 1        | 2         | 3         |

Figura 6, Matrica e Rrezikut

Bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të rrezikut, auditorët mund ta aplikojnë një shkallë të rangimit (e lartë, e mesme, e ulët) në mënyrë që të përcaktojnë nëse do ta përfshijnë sektorin funksional ose subjektin në planin strategjik.

Një mjet shembull i një Matrice të Rrezikut me vlerësim të përfshirë të rrezikut është dhënë në **Shtojcën 3, fleta Excel 2**.

**Rezultati i analizës së rrezikut:** Rreziqet e identifikuara për fushë/ subjekt funksional vlerësohen dhe caktohen në nivel rreziku.

### 3.2.3. VLERËSIMI I RREZIKUT (RANGIMI)

Pas realizimit të vlerësimit të rrezikut, fushat e vlerësuara të auditimit vlerësohen dhe u jepet një renditje prioritare. Ekzistojnë tri qasje kryesore për renditjen e rreziqeve:

1. Gjykimi profesional
2. Marrja e vendimeve bazuar në precedentin historik
3. Zbatimi i modelimit për t'i zgjedhur rreziqet më të rëndësishme.

**Rezultati i vlerësimit të rrezikut:** Një listë e shkurtër e fushave prioritare të auditimit

## 3.3 PËRGATITJA DHE MIRATIMI I DRAFT PLANIT STRATEGJIK TË FAP, DUKE PËRFSHIRË NJË LISTË TË FUSHAVE PRIORITARE PËR AUDITIM

Si hap tjetër, ekipi i planifikimit strategjik përgatit një plan trevjeçar për punën e auditimit të performancës që përfshin një listë të fushave/sectorëve potencialë në bazë të të cilave do të zgjidhen temat e auditimit për vitin e caktuar. Draft plani i auditimit strategjik përgatitet nga ekipi i caktuar i planifikimit strategjik dhe dorëzohet për shqyrtim dhe miratim nga Menaxhmenti i Lartë i FAP dhe AP brenda afatit të parashikuar.

Plani strategjik i auditimit të FAP i mbulon fushat kryesore të mëposhtme:

— **Misioni, vizioni, vlerat dhe objektivat strategjike të ZKA-së** sipas planit strategjik të institucionit.

- **Objektivat e auditimit të performancës:** Këto rrjedhin nga mandati ligjor i ZKA-së. Kryesisht, auditimi i performancës është një ekzaminim i pavarur, objektiv dhe i besueshëm nëse angazhimet, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet apo organizatat e qeverisë veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë (minimizimi i kostos së burimeve), efikasitetit (shfrytëzimi maksimal i burimeve në dispozicion) dhe efektiviteti (përmbushja e objektivave të vendosur dhe rezultateve të synuara).
- **Politikat e auditimit të performancës:** Ky seksion i përshkruan politikat dhe procedurat ekzistuese që zbatohen nga FAP për rritjen e performancës dhe cilësisë së rezultateve. Ai përfshin Manualin e Auditimit të Performancës dhe përditësimet e tij; sistemin elektronik të menaxhimit të auditimit; sigurimin e trajnimeve përkatëse dhe mundësive të tjera të zhvillimit; përdorimin e sistemeve të TI-së, etj.
- **Burimet:** Ky seksion paraqet Funkcionin e Auditimit të Performancës si dhe pozitat dhe numrat e punonjësve sipas Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e pozitave të punës. Plani e specifikon edhe fleksibilitetin e strukturës organizative dhe transferimin e stafit/ pozitave brenda FAP në përputhje me detyrat specifike. Gjithashtu duhet të theksohet mundësia e kontraktimit të jashtëm.
- **Fushat e propozuara të auditimit potencial** për periudhën përkatëse trevjeçare paraqiten bazuar në qasjen e zgjedhur, p.sh. sektori/ njësia funksionale. Rezultatet e vlerësimit të kryer të rrezikut mund të përfshihen gjithashtu si Shtojca të planit strategjik të auditimit.

Kur të përfundojë drafti i planit strategjik të auditimit, rezultatet, duke përfshirë një listë të propozuar të fushave prioritare për auditim në tre vitet e ardhshme, i paraqiten Menaxhmentit të Lartë të FAP dhe Auditorit të Përgjithshëm për shqyrtim dhe miratim.

Pasi të miratohet nga AP, plani strategjik i FAP i komunikohet stafit të ZKA-së për të siguruar që puna e auditorëve të jetë në linjë me sektorët/ njësitë prioritare dhe objektivat për periudhën trevjeçare.

Një model i një plani strategjik të auditimit të FAP është paraqitur në **Shtojcën 4**.

**Rezultati i Hapit 3:** Një plan auditimi strategjik trevjeçar i FAP që përfshin një listë të fushave prioritare për auditimin e performancës.

## 4. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË

Ky seksion përshkruan rolet dhe përgjegjësitë brenda ZKA-së në procesin e planifikimit strategjik të auditimeve të performancës.

### Auditori i Përgjithshëm

Auditori i Përgjithshëm shqyrton dhe miraton Planin Strategjik të Auditimit të Auditimeve të Performancës dhe përditësimet e tij.

### Menaxhmenti i Lartë i Auditimit të Performancës

Menaxhmenti i Lartë përfshin Ndhmës-Auditorin e Përgjithshëm i cili është përgjegjës për auditimet e performancës dhe Drejtuesit e njësive të auditimit të performancës.

Menaxhmenti i Lartë duhet ta caktojë një ekip të planifikimit strategjik përgjegjës për ta realizuar planifikimin strategjik. Aspektet kryesore të mëposhtme përcaktohen nga Menaxhmenti i Lartë:

- Auditorët e performancës të cilët do të përfshihen në procesin e planifikimit strategjik. Kryesisht, ekipi i planifikimit strategjik do të përfshijë auditorë të lartë të performancës të cilët kanë përvojë në fushat kryesore funksionale
- Afati kohor i aktiviteteve
- Funksionet e Auditimit që do të kontribuojnë në procesin e planifikimit strategjik
- Akterët e jashtëm që përfshihen, nëse është e nevojshme (të audituarit, shoqëria civile, Kuvendi Kombëtar i Kosovës dhe palë të tjera).

### **Auditorët e performancës**

Auditorët e performancës përfshijnë drejtuesit e ekipeve, auditorët e lartë dhe auditorët nga Funksioni i Auditimit të Performancës brenda ZKA-së të cilët janë caktuar për ta realizuar planifikimin strategjik të aktiviteteve të auditimit të performancës.

Auditorët marrin pjesë si anëtarë në **ekipin e planifikimit strategjik** i cili përcaktohet nga Menaxhmenti i Lartë rast pas rasti dhe zbatojnë detyrat e caktuara në procesin e planifikimit strategjik duke ndjekur Udhëzimet aktuale.

Kryesisht, ekipi i planifikimit strategjik është përgjegjës për:

- Mbledhjen dhe strukturimin e informacionit të saktë dhe të përditësuar për fushën/ subjektin funksional duke përdorur mjetet dhe burimet e informacionit të përshkruar
- Përcaktimin e rrezeve të zonave funksionale/ subjekteve të sektorit publik duke aplikuar një qasje të bazuar në rrezik
- Diskutimin e brendshëm të propozimeve dhe identifikimin e fushave të mundshme që auditimi të përfshihet në planin strategjik
- Përgatitjen e draft planit strategjik për auditimin e performancës dhe listën e prioriteteve për auditim
- Paraqitjen e draft planit strategjik të FAP tek Menaxhmenti i Lartë i FAP dhe AP për shqyrtim dhe miratim brenda afatit të përcaktuar.

## **5. MONITORIMI I PLANIT STRATEGJIK**

Monitorimi është i nevojshëm për të siguruar që plani strategjik i auditimit të performancës është zbatuar dhe është mirëmbajtur i përditësuar. Menaxhmenti i Lartë është përgjegjës për ta monitoruar zbatimin e procesit të planifikimit strategjik dhe për ta siguruar cilësinë e rezultateve. Për këto qëllime, Menaxhmenti i Lartë duhet të:

- Sigurojë që aktivitetet të mbahen brenda parametrave të fushave prioritare të miratuara dhe objektivave strategjikë
- Sigurojë që aktivitetet të jenë në përputhje me vizionin, misionin dhe vlerat e ZKA-së dhe
- Mbajë nën shqyrtim ndryshimet e brendshme dhe të jashtme të cilat mund të kërkojnë rregullime në planin strategjik të FAP ose që ndikojnë në arritjen e objektivave.

Aktivitetet e vazhdueshme të monitorimit do të realizohen nga Menaxhmenti i Lartë periodikisht gjatë zbatimit të strategjisë përmes planeve vjetore të auditimit dhe sigurimit të cilësisë së auditimeve të veçanta.

Raportimi mbi përparimin e zbatimit të strategjisë së auditimit të performancës do të jetë pjesë e aktiviteteve vjetore të raportimit të auditimit të ZKA-së.

Menaxhmenti i Lartë mund të vendosë të aplikojë masa/tregues të performancës në mënyrë që ta monitorojë progresin e zbatimit të strategjisë së auditimit. Masa të tilla mund të përfshijnë:

- **Numri i auditimeve të performancës** që i raportohet Kuvendit
- **Afati kohor** i përfundimit të auditimeve të performancës
- **Kosto mesatare** të auditimeve të performancës, dhe
- **Rekomandimet e dakorduara dhe të zbatuara** nga subjektet e audituara.

Shembuj të masave të performancës janë paraqitur në **Shtojcën 5**.

## 6. RISHIKIMI DHE PËRDITËSIMI I PLANIT STRATEGJIK

Plani strategjik i auditimit të FAP i nënshtrohet një rishikimi të rregullt, të paktën çdo vit (si pjesë e procesit të planifikimit të auditimit vjetor), në mënyrë që të mbahet i përditësuar dhe të pasqyrojë zhvillimet në fushën ekonomike, politike, sociale, fushat teknologjike, mjedisore dhe ligjore në Kosovë.

Ndryshimet në lidhje me planin strategjik të auditimit inicohen nga Menaxhmenti i Lartë i FAP dhe zbatohen nga auditorët që mbështesin procesin.

Përditësimet e planit strategjik miratohen nga Auditori i Përgjithshëm.

Një model për shqyrtimin dhe miratimin e dokumentit jepet në **Shtojcën 6**.

## **SHTOJCA I: SHEMBULL STUDIMI I PËRGJITHSHËM (WORD)**

## **SHTOJCA 2: LISTA E SUBJEKTEVE TË SEKTORIT PUBLIK - TË AUDITUARIT (EXCEL)**

## **SHTOJCA 3: MODELI I VLERËSIMIT TË RREZIKUT (EXCEL)**

## SHTOJCA 4. MODELI I PLANIT STRATEGJIK TË AUDITIMEVE TË PERFORMANCËS

### HARTIMI I PLANIT STRATEGJIK TË AUDITIMIT TË FUNKSIONIT TË AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

#### PËR PERIUDHËN (përcaktohet një periudhë trevjeçare)

Miraturar nga Auditori i Përgjithshëm .....

Fushat kryesore të përfshira:

**1. Misioni, vizioni, vlerat dhe objektivat strategjikë të ZKA-së**

**2 Objektivat e Auditimit të Performancës**

**3. Politikat e Auditimit të Performancës**

**4. Burimet**

**5. Fushat e propozuara të auditimit të mundshëm:** Një listë e fushave ose nënfushave funksionale prioritare për auditim, bazuar në të cilat temat dhe subjektet e auditimit do të përzgjidhen për auditim brenda periudhës përkatëse. Është përgatitur bazuar në rezultatet e procesit të planifikimit strategjik.

| Fusha prioritare e identifikuar në 20xx-20xx                              | Renditja                                      | Racionalizimi                                                                    |
|---------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------|
| <i>Fushat prioritare për 2019-2021:</i><br><b>1. Shëndeti dhe Siguria</b> | Bazuar në rezultatet e vlerësimit të rrezikut | Bazuar në rezultatet nga hapat e realizuar në procesin e planifikimit strategjik |
| <b>2. Zhvillimi ekonomik dhe mbrojtja e mjedisit:</b>                     |                                               |                                                                                  |
| <b>3. Mjedis</b>                                                          |                                               |                                                                                  |
| <b>4. Prokurimi Publik</b>                                                |                                               |                                                                                  |
| <b>5. Teknologjia e informacionit</b>                                     |                                               |                                                                                  |
| <b>6. Shoqëria civile</b>                                                 |                                               |                                                                                  |

## SHTOJCA 5: SHEMBULL MASAT E PERFORMANCËS

Për ta vlerësuar performancën kundrejt aktiviteteve të planifikuara të auditimit të performancës, ZKA-ja mund të masë:

- Numrin e auditimeve të paraqitura të performancës
- Afatin kohor të përfundimit të auditimeve të performancës
- Koston mesatare të auditimeve të performancës, dhe
- Përqindjen e rekomandimeve të dakorduara dhe zbatuara nga subjektet e audituara.

| Numri i auditimeve të paraqitura të performancës                       | Afati kohor i përfundimit të auditimeve të performancës                                                            | Kostoja mesatare e auditimeve të performancës                                                                                                                                                   | Përqindja e rekomandimeve të dakorduara dhe të zbatuara                                                      |
|------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Numëroni raportet e auditimit të performancës të prezantuar në Kuvend. | Koha e kaluar regjistrohet nga miratimi i planit të punës së auditimit deri në raportin përfundimtar të auditimit. | Kostot e të gjitha auditimeve të performancës të paraqitura në vitin financiar të raportuar pjesëtuar me numrin e auditimeve në krahasim me vitin e kaluar duke përdorur të njëjtën llogaritje. | Numëroni rekomandimet e dakorduara/lëshuara pjesëtuar me numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të zbatuara. |

Burimi: Zyra Kombëtare e Auditimit Australiane (ANAO)

## SHTOJCA 6: SHABLLONI I RISHIKIMIT DHE MIRATIMIT TË DOKUMENTIT

Rishikimi dhe miratimi i dokumentit

Historia e rishikuar

| Versioni | Autori | Data | Rishikimi |
|----------|--------|------|-----------|
|          |        |      |           |
|          |        |      |           |
|          |        |      |           |
|          |        |      |           |
|          |        |      |           |

Ky dokument është rishikuar nga

|   | Rishikues | Data e rishikuar |
|---|-----------|------------------|
| 1 |           |                  |
| 2 |           |                  |
| 3 |           |                  |
| 4 |           |                  |
| 5 |           |                  |

Ky dokument është miratuar nga

| Ekspertë të lëndëve |            |                  |
|---------------------|------------|------------------|
| Emri                | Nënshkrimi | Data e rishikuar |
| 1                   |            |                  |
| 2                   |            |                  |
| 3                   |            |                  |
| 4                   |            |                  |
| 5                   |            |                  |

## **SHTOJCA 7: LISTA E BURIMEVE**

1. Plani strategjik i ZKA të Kosovës 2018 -2021
2. Plani vjetor i auditimit të ZKA të Kosovës 2020/2021
3. ISSAI 300, Parimet e Auditimit të Performancës
4. Përdorimi i Vlerësimit të Rrezikut në Planifikimin e Auditimit të Performancës Shumëvjeçare, OECD, 2018
5. Zyra Kombëtare e Auditimit Australian (ANAO), Webfaqja Zyrtare
6. Manuali i Auditimit të Performancës i Zyrës Kombëtare të Auditimit të Maltës